



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL ASSEMBLY- SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Ne baze të nenit 12, paragrafi 1 dhe 2, shkronja (d), lidhur me nenin 14 dhe 17, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008”, e në mbështetje të nenit 15, lidhur me nenin 29, pika 2 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën,-----, miratoi këtë:

Projekt-V E N D I M
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E XHAMISË

Neni 1

1.1 Me këtë vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e Xhamisë, për lagjen e “Shirokë” në pjesën e parcelës kadastrale **P-72116043-00804-0**, me sipërfaqe të përgjithshme prej; **10951m²**, sipas certifikatës së pronës **nr.1165/2023**, datës 13.03.2023, zona kadastrale **Sopijë**, vendi i quajtura **“Drum/Shiroko”** e evidentuar pasuri shoqërore në emër të Komuna e Suharekës.

1.2 Nga sipërfaqja e përgjithshme e parcelës të cekur në pikën 1.1, të nenit 1, të këtij vendim ndahen **1200m²** për ndërtimin e “Xhamisë”, për lagjen e “Shirokë”, ndërsa pronari i përhershëm i pronës mbetet Komuna e Suharekës.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim dhe Drejtoria për Shërbime Pronësore-Juridike dhe Kadastër e Komunës së Suharekës, të cilat do të bëjnë parcelizimin dhe skicimin në teren dhe regjistrimin e gjendjes në librat kadastrale.

Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS– SUHAREKË

01-Nr-_____
Më datë_____

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI